



KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI

RREGULLORE
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE
E FAKULTETIT TË DREJTËSISË

Tiranë, 2025



[Handwritten signature]

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë mësimore-shkencore të Fakultetit të Drejtësisë në përputhjeje me objektivat dhe misionin e tij, duke nxitur veprimtarinë kërkimore-shkencore dhe akademike të personelit akademik, si dhe orjentimi i studentëve drejt kërkimit shkencor të vlefshëm për tregun e punës, në nivel kombëtar e ndërkombtar.

Neni 2

Baza ligjore

Rregullorja e Qendrës Kërkimore Shkencore (në vijim QKSH) në Fakultetin e Drejtësisë mbështetet në Ligjin nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", aktet nënligjore në zbatim të tij, në Statutin dhe në rregulloren e Kolegjit Universitar "Qiriazi", si dhe rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë (FD në vijim)

Neni 3

Fusha e zbatimit

QKSH është njësi bazë kërkimore shkencore që zhvillon veprimtaritë e saj në përputhje me misionin dhe fushat e përgjegjësisë dhe u nënshtrohet kriterëve të financimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Ajo ka detyrimin të publikojë veprimtarinë e saj, si dhe rezultatet në revista shkencore, botime shkencore etj, duke garantuar integrimin e veprimtarisë kërkimore me procesin mësimor akademik.

Nenin 4

Fushat e veprimit

1. Veprimtaria e QKSH bazohet në strategjinë e kërkimit shkencor në përputhje me politikat dhe objektivat e FD -së.
2. Qendra mund të mbështetë realizimin e programeve të studimit "Master i Shkencave" të orfruara nga departamentet e FD.
3. QKSH ka në fokus të saj:
 - a. të nxitë dhe mbështesë nisma në fushën e kërkimit shkencor mes njërive bazë, si dhe të realizojë koordinimin me institucionet akademike brenda dhe jashtë vendit.
 - b. të nxitë dhe zhvillojë kapaciteteve dhe vlerat e fakultetit në përputhje me zhvillimet në treg, me konkurrencën dhe nivelin e jetesës.
 - c. plotësimin e standardeve dhe kriterëve për akreditim e programeve të studimit brenda fakultetit dhe KUQ etj.

KREU II

ORGANIZIMI I QENDRËS KËRKIMORE SHKENCORE

Neni 5

Organizimi

1. Qendra Kërkimore Shkencore (QKSH) është njësi bazë në FD që kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi.
2. Qendra Kërkimore Shkencore (QKSH) drejtohet nga drejtuesi i QKSH.

Neni 6 Detyrat

QKSH kryen këto detyra:

1. Harton programin e masave për çdo vit akademik, ku pasqyrohen drejtimet kryesore të veprimtarisë, të miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore.
2. Paraqet për miratim të drejtuesi i njësisë kryesore projekte kërkimore dhe mësimore, të orientuara nga standardet bashkëkohore.
3. Organizon konsulta për tema të rëndësishme që lidhen me politika dhe projektet e fakultetit, veçanërisht për lidhjen e kërkimit shkencor me mësimdhënien.
4. Bashkërendon dhe koordinon veprimtarinë kërkimore të njësive bazë, duke respektuar liritë akademike të personelit akademik.
5. Mbështet përfshirjen e personelit akademik për t'u bërë pjesë e projekteve institucionale apo ndëruniversitare.

Neni 7

Drejtuesi i Qendrës Kërkimore Shkencore

1. Drejtuesi i njësisë kryesore i propozon kandidaturën për drejtues të QKSH rektorit.
2. Drejtuesi i QKSH është personel akademik i kategorisë "Profesor". Kolegji Universitar "Qiriazi", për rrethana të justifikuara, mund të përzgjedhë si përgjegjës të njësisë bazë nga personeli akademik me gradë shkencore "Doktor" ("PhD") të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në rast kur nuk ka kandidat të kësaj kategorie, ai mund të jetë edhe me gradën shkencore "Doktor".
3. Mandati i drejtuesit të njësisë bazë zgjat katër vjet, me të drejtë ripërzgjedhje vetëm një herë.
4. Organizon dhe drejton punën e aktiviteteve shkencore dhe të promovimit të botimeve e artikujve shkencor në revistën periodike shkencore të institucionit apo në revista shkencore ndërkombëtare.
5. Realizon konferenca shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për pedagogët, kërkuesit shkencorë dhe studentët.
6. Analizon periodikisht punën kërkimore-shkencore të njësive bazë dhe propozon ose merr masa për përmirësimin e mëtejshëm të saj.
7. Është vlerësues metodologjik për studentët dhe për punimet e diplomës së tyre.
8. Detyrat dhe kompetencat e tij janë:
 - a) Drejton dhe synon të garantojë integrimin e veprimtarisë kërkimore shkencore në atë të mësimdhënies.
 - b) Bashkërendon punën me drejtuesit e departamenteve dhe kontribuon në analizën e planeve mësimore dhe programeve të studimit, si dhe të syllabuseve specifike.

- c) Propozon dhe organizon konferenca shkencore, tryeza të rrumbullakëta, workshop-e, etj në nivel të FD apo edhe të Kolegjit.
- d) Bashkëpunon me institucione të tjera publike ose private, brenda dhe jashtë vendit në kuadër të kërkimit shkencor duke marrë pjesë në konkurrimin e projekteve të hapura nga Bashkia apo institucione të tjera duke kontribuar në zhvillimin e vendit dhe në buxhetin e Kolegjit.
- e) Ajo ndihmon me hulumtime në hapjen e programeve të reja të studimit.
- f) Kryen studime me interes për nevoja të Fakultetit dhe të Kolegjit.

Neni 8

Vlerësimi i performancës

1. Niveli i performancës së QKSH vlerësohet nëpërmjet ndërveprimit të vijueshëm të kërkueseve shkencor në realizimin e botimeve shkencore, pjesëmarrjes në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.
2. Vlerësimi i performancës së kërkuesit-shkencor, vlerësohet në frekuentimin dhe pjesëmarrjen aktive në leksione të hapura, seminareve, mentorimin e studentëve ekselentë.
3. Vlerësimi i performancës së QKSH mbështetet në pjesëmarrjen aktive në shkëmbim eksperiencash në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
4. Vlerësimi i performancës së QKSH bazohet në realizimin dhe botimin e librave, monografive apo cikël leksionesh nga personeli akademik dhe kërkuesit shkencorë.

Neni 9

Transparenca

1. Me qëllim të sigurimit të transparencës së punës kërkimore-shkencore, kërkuesit-shkencor raportojnë periodikisht në dekanat për produktet e planifikuara që realizohen nga njësia.
2. QKSH publikon punën kërkimore shkencore nëpërmjet:
 - a. dorëzimit dhe promovimit publik të krijimtarisë (artikujve shkencor, kumtesa, cikle leksionesh, konferenca etj.) të kërkueseve shkencorë;
 - b. promovim të punës së kërkueseve-shkencor në websitin zyrtar si edhe në rrjetet sociale të KUQ.

KREU III

DEPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 10

Aktet e ndryshme të QKSH sipas specifikave të tyre, duhet të harmonizohen me dispozitat e kësaj rregullore.

Neni 11

Çdo ndryshim në këtë rregullore bëhet me propozim të QKSH, me miratim të Dekanatit të Fakultetit dhe vendim të Senatit Akademik.

Neni 12

Kjo rregullore e shtrin veprimtarinë e saj duke filluar nga viti akademik 2025-2026.

Me miratimin e Vendimit të Senatit Akademik të Kolegjit Universitar "Qiriazi" Nr. 42/12
Datë 18/04/2025.

**Kryetar i Senatit Akademik
Prof. Dr. Gjokë ULDEDAJ**

